

## BARDHYL DEMIRAJ

### ZHVILLIME TË LARINGALEVE NISTORE IE. NË SHQIPE SEKUENCA \*HRC-

#### Problematika dhe diskutimi përkatës

Zhvillimet e fundit në indoевropianistikë dhe në albanologji kanë rishtruar për diskutim një problem, i cili më parë mendohej i zgjidhur. Në njërin prej studimeve të tij mbi marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-armene Kortlandt-i (1986 44 v.) tërheq vëmendjen për një zhvillim paralel të mundshëm në këto dy gjuhë, që është "...perhaps the twofold nonzero reflex of PIE \**H₂*- and \**H₃*-, which vocalized before a tautosyllabic resonant, as in Greek, and yielded aspiration before PIE \**e*". Këtë mendim duket se e pranon edhe Beekes-i (1988 102 v.; 1995 267). Kjo ka bërë që të lëkundet pjesërisht teza e Hamp-it (1960 185 v.; 1965 123 v.), e pranuar deri diku edhe prej ndonjë gjuhëtari tjeter indoevropianist dhe albanolog, sipas së cilës në shqipe nuk ndeshen gjurmë të laringaleve nistore indoevropiane (= ie.). me përjashtim të rasteve kur ato ndodhen në pozicion parazanor<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Huld 1984 151 v.: një vështrim kritik ndaj zbatimit të teorisë së laringaleve ie. në gjuhën shqipe ndërmerr Ölberg-u 1972a 121 vv. Në punim pranojmë si më të mbështetur tezën që rindërtion për gjuhën bazë ie. tri fonema laringale (me vlerën fonetike të një fërkimori), të cilat shenjohen konvencionalisht me /h₁/, /h₂/, /h₃/. e që në pozicion parazanor e ndërzanor ndikojnë zanoren /e/ me ngjyrimet zanore përkatësisht [e] (= ngjyrim neutral), [a] dhe [o]. ndërsa në pozicion ndërmjetës midis një zanoreje çfarëdo dhe një bashkëtingëlloreje dhe në pozicion fundor shkaktojnë krahas ngjyrimit zanor (kjo gjithashtu vetëm në bashkëlidhje me zanoren e ngritisë së mesme /e/) edhe zgjatjen e saj (në bashkëlidhje me çdo zanore). Gjurmë të laringaleve ie. me funksion bashkëtingëller identifikohen vetëm në grupin anatolik (p.sh. hetitishqja që dëshmon një bashkëtingëllore fërkimore h) e pas gjithë gjasash. sipas Hamp-it (vend. cit.), edhe në shqipe në disa fjala që nisin me spiratin /h/. Le t'i ilustrojmë këto dukuri fonologjike tejet të lashta me disa shembuj nga fusha e shqipes: a) me laringalin *\*h₁*: (i) *jetér* < protoshq. (-)\*éter- : ie. \*/h₁e-ter-/; khs. umbr. *etro* "tjetër"; *jashtë* < protoshq. \*/é(C)stá-/ : ie. \*/h₁egʰs-to-/; gr. (lok.) ἔχθος "jashtë"; (ii) *epér* < protoshq. \*/ápir-/ : ie. \*/h₁opi-ro-/; khs. gr. ὄπιθε(v) "prapa"; mot < protoshq. \*/mēt-/ : ie. \*/meh₁-t-/; khs. lit. metas "mot. kohë"; (iii) *blerë*, *blertë* < protoshq. \*/blōrā-/ : ie. \*/b<sup>h</sup>loh₁-ro-/; khs. lat. *flōrus* "i verdhë, blu" etj.; b) me laringalin *\*h₂*: (i) *ethe* "zjarmi" < protoshq. \*/háiθ/ð-/ : ie. \*/h<sup>h</sup>eidʰo-/; khs. gr. αἴθος "zjarr"; (ii) *hídhë* < protoshq. \*/hið-(tā)/ : ie. \*/h<sup>h</sup>idʰ-/; khs. gr. ιδηπός "i kthjellët"; motër, motre < protoshq. \*/mátri/ : ie. \*/meh<sup>h</sup>₂tr<sup>h</sup>/; khs. lat. māter "nënë"; ti < protoshq. \*/tū/ : ie. \*/tuh<sup>h</sup>/; khs. lit. tū "ti" etj.; c) me laringalin *\*h₃*: *herdhe* < (dual) protoshq. \*/hárði/ < \*/horgʰ-í-/ : (dual) ie. \*/h<sup>h</sup>ergʰ-ih<sup>h</sup>/; arm. *orjik* "herdhe". gr. ὥρχεται "herdhe"; *tetë* < protoshq. \*/alō-tā/ : ie. \*/(H)oktoh<sup>h</sup>/; khs. lat. octō etj.

Ndër shenjat e tjera konvencionale që kemi përdorur në punim, përmendim: V (= çdo fonemë me vlerë zanore). C (= çdo fonemë me vlerë bashkëtingëllore). R (= çdo bashkëtingëllore sonante -r/, /l/, /n/, /m/ - me tiparin fonologjik [± rrökjebartës]. H (= çdo laringal).

Rishtrimi i këtij problemi, i cili edhe në plan ie. është ende i diskutueshëm<sup>2</sup>, na nxit që të pjesëmarrim në shtjellimin e tij, duke paraqitur si më të mbështetur njëren apo tjetrën tezë të hedhur deri më sot, si edhe duke sjellë sipas rastit ndonjë argument të ri lidhur me rrugën e zhvillimit dhe shkallën e shtrirjes së dukurive të ndryshme fonologjike që paravndon sekuenca \*HRC- në gjuhën shqipe.

Gjatë interpretimit fonologjik të materialit gjuhësor që ngërthen sekuenca në fjalë studiuesit kanë dhënë për çdo rast në veçanti shpjegime alternativë të ndryshme. Ndërsa mund të përmendim këtu:

a) ose ajo nuk ekziston, ose është zëvendësuar qysh herët me sekuençen \*HVR<sub>C</sub>-, p.sh. në njësitë *im/em*, *ndër*, *ndër*, *ari*, *erdhu* etj.;

b) bjerrje të laringalit nistor, përkatësisht thjeshtim në sekuençen \*RC-, p.sh. në njësinë *emér*:

c) shndërrim i sekuençës \*HRC- në \*VRC-, çka parakupton një zhvillim fonologjik të trefishtë, të ngjashëm me atë që është përfshuar në greqishte (Rix 1969 79 vv.): vokalizim i laringalit nistor, çrrrokjesim i sonantit ndjekës dhe zhvendosje e njëkohshme e majës së rrokjes mbi laringalin e vokalizuar, i cili sipas rastit mund të jetë \*/h<sub>2</sub>/ ose \*/h<sub>3</sub>/, domethënë me ngjyrim vokalik drejt zanoreve /a/, përkatësisht \*/o/.

Lidhur me shpjegimet e mësipërme, do vënë në dukje se i pari është përdorur gjithnjë si faktor ndihmës për dy të tjerët, që nuk arrijnë të shtjellojnë problemin në tërësinë e tij. Kjo për vetë faktin se njësitë gjuhësore që vijnë në vështrim kanë në pozicion nistore zanoret /e/- ose /a/. Kështu, teza që parakupton një bjerrje të laringalit nistor në protoshqipe, interpreton si vijuese të drejtpërdrejtë të kësaj sekuence ato njësi që kanë një /e/- nistore: ie. \*HRC- → protoshq. \*RC- → shq. *eRC*-; ndërsa teza tjetër që supozon ruajtje të laringalit nistor, arrin të shpjegojë vetëm njësitë me /a/- nistore ose disa syresh që duhet të kenë pasur në zanafillë një tingull të tillë nistor, i cili me kohë erdhë i iu nënshtrua dukurisë së metafonisë: ie. \*H<sub>2-3</sub>RC- → \*a/oRC → protoshq. \*aRC- → (me ose pa metafoni) shq. *a/eRC*.

Pa dashur të ndalemi më hollësishët në këto teza, vërejmë se krahas disa mangësive në mënyrën e interpretimit të sekuençës në shqyrtim, diktohet edhe ndonjë mospërputhje me trajtimin e derisotëm të sonanteve rrokjebartëse ie. në gjuhën shqipe nga njëra anë, si edhe me zhvillimin e laringalit \*/h<sub>1</sub>/ në pozicion nistor nga ana tjetër.

Megjithëse refleksi i sonanteve rrokjebartëse ie. në shqipe vijon të mbetet një çështje e pazgjidhur shterueshëm në fonologjinë historike të shqipes, ballafaqimi i rezultateve të arritura deri më sot mënjanon tezën që mbron një zhvillim të njësuar \*RC- → shq. *eRC*- . Kështu, mendimi më i mbështetur mbi reflektimin e hundoreve (të theksuara), qofshin këto edhe në pozicion nistor, është vokalizimi i plotë i tyre në /a/, në kushtë të caktuara fonetike edhe në /u/ , ndërsa lëngëtoret shfaqin reflekset përkatëse /R/ dhe /uR/ (Demiraj 1997a 69 v., 76 v.; 1997b 50 v.)<sup>3</sup>. Këto të dhëna e lëkundin mjaf tezën e Hamp-it.

<sup>2</sup> Për veprimin e të ashtuquajturit "Lex Rix" në greqishte dhe për problematikën përkatëse sh. Mayrhofer 1986 121 vv., Lindeman 1986 79 vv.

<sup>3</sup> Për historinë e shqyrtimit të reflekseve të sonanteve rrokjebartëse ie. në gjuhën shqipe sh. së fundi Sh. Demiraj 1997 159 vv.

Mënjanimi i laringalit *\*h<sub>1</sub>* nga shtjellimi i sekuencës *\*HRC-* duket se është bërë për të vetmen arsy, se nistorja protoshq. *\*e-/që* pritej të përftohej nga vokalizimi i tij duhej t'i nënshtrohej rregullisht diftongimit në */je-/*, */ja-/* në periudhën historike të shqipes, gjë që bie në kundërshtim me strukturën fonologjike të atyre pak njësive që vijnë në analizë. Po të lëmë mënjanë faktin, se ende nuk janë përcaktuar parametrat fonetikë të kësaj *\*e-/je*, ndaj kësaj dilemë mund të ngritet së paku objekzioni, që një *e/* e shqipes jo gjithmonë i është nënshtruar diftongimit. Mjafton të përmendim këtu si të sigurt rastin kur ajo ndiqet prej një grupei bashkëtingëllor, i cili u është nënshtruar proceseve të ndryshme fonologjike që i paraprijnë diftongimit të saj: khs. *pesē* < ie. *\*penkʷe*.

Sic del edhe nga kjo paraqitje tepër e përbledhur, hulumtimi i sekuencës *\*HRC-* në shqipe kërkon një spektër më të gjerë vështrimi, ku duan mbajtur parasysh mundësitë e veprimit të dukurive të ndryshme fonologjike si edhe vendosja e tyre e përpiktë në zinxhirin kronologjik. Nga ana tjetër, duke qenë se vijnë në vështrim dukuri të parahistorisë së gjuhës dhe se materiali gjuhësor që ofron shqipja e dokumentuar është relativisht i rrudhur, rëndësi të dorës së parë merr zbatimi i kriterieve rigorozë që i jep siguri si rindërtimit të brendshëm ashtu edhe krahasimit në plan ie. për çdo njësi në veçanti. Ndër to përmendim:

a) Nëpërmjet krahasimit të jashtëm duhet të vërtetohet bindshëm për çdo njësi prania e një laringali nistor dhe e një sonanti rrokjebartës në rrokje nistore. Këtu fiton rëndësi të vegantë krahasimi me greqishten, si e vetmja gjuhë ie. që i dëshmon qartë këto bashkëlidhje në mjedisin në shqyrtim<sup>4</sup>.

b) Rindërtimi i brendshëm ngérthen çdo njësi në shqyrtim brenda tipit tematik dhe fjalëformues përkatës. Për këtë arsy duhen parë si të sigurta vetëm ato raste, në të cilat vërtetohet një shkallë ablative zero për rrokjen nistore.

c) Ato etimone që nuk jep siguri të plotë gjatë rindërtimit brendagjuhësor dhe krahasimit të jashtëm duhen vlerësuar si raste ambigue, duke i dalluar kështu prej shembujve të sigurtë.

Le të kalojmë tani në shqyrtimin e materialit gjuhësor që ofron gjuha shqipe. Njësitetë i kemi klasifikuar në tri grupe, sipas natyrës së laringalit nistor që vjen në analizë.

### Raste me laringalin *\*h<sub>1</sub>*

1. *emēr*, khs. gr. ὄνομα, gr. dor. ἔνωμα, arm. *anun*, lat. *nōmen*, sll. vj. k. *imę*, irl. vj. *ainm*, prus. vj. *emnes* etj.: ie. *\*h<sub>1</sub>neh<sub>3</sub>mṇ*, gjin. nj. *\*h<sub>1</sub>ṇm(e)n-* ( $\leftarrow *h_1nh_3m(e)n-$ ). Ashtu si disa gjuhë ie. (Schindler 1973 262 v.) shqipja duket të ketë përgjithësuar si temë të fjalës në paradigmën e këtij asnjani së lashtë formën e gjinores njëjës me shkallë ablative zero në rrokjen nistore, sic është rasti edhe për emrat e tjerë, burimorë asnjani së *\*{-men-}*, khs. *dimēr*, g. *dimēn* : ie. *\*g<sup>b</sup>im(e)n-* (Demiraj 1997a 133).

<sup>4</sup> Sh. Rix 1969 79 vv., Mayrhofer 1986 129 v.; për pozicionin ende të pasqaruar të armenishtes sh. Lindeman 1990 25 v.

Në interpretimin fonologjik të strukturës në shqyrtim, supozimi mbi një bjerrje të hershme të laringalit nistor dhe zhvillimi \*/ŋ/ → shq. /en/ i sonantit ndjekës bie në kundërshtim me rregullsitë e reflektimit të sonanteve hundore ie. në shqipe. Mund të sjellim këtu për krasim fatin e formantit privativ ie. \*{ŋ} (→ shq. {a-}, ose me metafoni {e-}) në gjuhën shqipe (Pedersen 1924 222).

Mëngjanimi nga interpretimi fonologjik i një strukture të rindërtuar protoshq. \*/ŋm(e)n-/ e rrit edhe më tej probabilitetin e deduksionit mbi dukurinë e veçantë fonologjike në bashkëlidhjen *laringal + sonant rrokjebartës*, që është pikërisht vokalizmi i laringalit, i shoqëruar ky me çrokjesimin e sonantit ndjekës: \*/h,ŋmen-/ : protoshq. \*/enmVn-/ > t. *emér*, g. *emén*. Në këtë rast nuk mund të qëndrojë edhe ndonjë hezitim i mundshëm lidhur me mungesën e diftongimit të zanores /e-/. Kjo, ndër të tjera, edhe për faktin se ajo ndodhej qysh herët para një bashkëtingëllorreje hundore.

2. *endem* : ie. \*/h,ŋd<sup>b</sup>/-/, khs. gr. (Aor.) ἐνθεῖν “vij”, ind. vj. *ádhvan* “udhë” (Demiraj 1997b 167)<sup>5</sup>. Mungesa e marrëdhënieve paradigmatike ablautive të kësaj foljeje është pas gjithë gjasash rezultat i përgjithësimit të një teme follore me rrënje në shkallën ablautive zero që nuk ndërtohej mbi bazën e kohës së tashme. Zhvillimet fonologjike në ballin e fjalës dëshmojnë një paralelizëm të plotë me ato të njësisë *emér*.

3. *ndë, në* : ie. \*/h,ŋd<sup>b</sup>/-/ (Kortlandt 1986 45) - Në rast se rindërtimi i Hamp-it (1977 145 v.) është i rregullt, sipas të cilit në bazë të disa parafjalëve lokative “në, ndër, ndën” (khs. gr. ἐν, ἐνί, ἐνθα, lat. *en*, ind. vj. *ádhhi* etj.) qëndron një emër i lashtë \*/h,ŋen-/ “interior”, atëherë shq. *ndë* (→ *në*) bashkohet natyrshëm me grupin e parafjalëve që dëshmojnë një lokativ të ngurrosur në shkallën ablautive zero: \*/h,ŋd<sup>b</sup>i/, khs. ind. *ádhhi*, irl. vj. *ind* etj.

Bjerra e hershme e zanores nistore në njësinë në shqyrtim shpjegohet me faktin se ajo është përdorur qysh herët në proklizë. Ky fakt e vështirëson disi interpretimin fonologjik të rrokjes nistore. Gjithsesi ruajtja e nistores /n/- pa tiparin fonologjik [+ rrokjebartës] është një tregues që dëshmon se në një periudhë të caktuar të evolucionit të protoshqipes ajo i është nënshtuar një procesi çrokjesimi, të shkaktuar pikërisht nga prania e laringalit paraprijës, i cili pritej të vokalizohej.

Megjithatë, mungesa e transparencës strukturore në shqipen e dokumentuar nuk na lejon që ta bashkojmë njësinë në shqyrtim në rastet më të sigurta që dëshmojnë vokalizimin e një lariqali nistor para një sonanti hundor rrokjebartës në gjuhën shqipe.

4. *ndër-* Në të njëjtin përfundim të çon edhe analiza diakronike e kësaj parafjale, të cilën Hamp-i (1965 136) e krahason me lat. *inter*, arm. *ənderk* “angurrë”,

<sup>5</sup> Ölberg-u (1927b 27) vë në dyshim me të drejtë afrimin e mëparshëm të Çabejt (SGJ II 161) me (ilir.) Tarant. ἀνδινος περίπατος (Illes.). Në vështirësi të karakterit semantik ndesh edhe afrimi i dytë, i bërë nga Çabejt (1997 81) me foljen *end* “bëj pëlharë”. Sh. për këtë Demiraj 1997b 167.

sll. vj. k. *jçtro* “mëlçi”, duke rindërtuar përgjegjësen e shqipes dy variante të mundshme formative: \*/h<sub>1</sub>nter-/; \*/h<sub>1</sub>entr-/<sup>6</sup>.

5. *im* (< (*i*) *em*) - Hamp-i (1960 187 - me dyshim; 1965 135) dhe Kortlandt-i (1986 39) e krahasojnë këtë formë rasore të përemrit pronor me gjegjëset arm. *im* “my”, gr. ἐμός “mine”, het. *amug* “me”, lyk. *ēmu* “unë, mua” etj., duke rindërtuar paraformat \*/h<sub>1</sub>em-/, \*/h<sub>1</sub>m-/. Një afëri strukturore me gjegjëset greke dhe armene e ka vënë në dyshim më parë Meillet (1927 132). Pa dashur të ndalemi më hollësishët në interpretimin fonologjik të kësaj fjalëforme, vërejmë se ajo vështirë se mund të ndërkallet në sekuençën \*HRC<sup>7</sup>.

### Raste me laringalin \*/h<sub>2</sub>/

6. *ari*, \**ar* (sh. *arat*, Bogdani) - Ndër gjuhëtarët indoevropianistë dhe albanologë që zbatojnë teorinë e laringaleve vetëm Kortlandt-i duket se nuk heziton në barazimin e kësaj fjale me gjegjëset gr. ἀρκτος, arm. arj etj. : ie. \*/h<sub>2</sub>ṛt̪kos/, ndërsa Hamp-i nuk gjen rrugëzgjidhje. Sipas tij “... though one is reluctant to separate Albanian word from this close-knit group, the nature of connexion remains highly problematic, and the sequence is sui generis” (1965 141). Këtë ide autori e përforcon më vonë (1976 263), kur e shtjellon çështjen në plan ie.

Interpretimi etimologjik i njësisë *ari* është i lidhur kryekëput me krahasimin e jashtëm, përderisa ajo mbetet e izoluar në të gjitha gjuhët ie. Rindërtimi i formës bazë ie. \*/h<sub>2</sub>ṛt̪ko/- pranë variantit me metatezë \*/h<sub>2</sub>ṛkpos/ (Schindler 1977 30; Mayrhofer 1986 153) lejon gjithsesi që edhe për gjegjësen shqipe të merret në vështrim zhvillimi i mundshëm fonologjik \*/h<sub>2</sub>ṛC-/ → protoshq. \*/arC-/ që parakupton vokalizimin e laringalit nistor dhe çrrrokjesimin e vibrantit ndjekës. Në këtë kuadër merr rëndësi të veçantë shpjegimi i bjerrjes së plotë të rrokjes fundore ie. \*/-t̪ko/- në gjegjësen e shqipes.

Duke lënë mënjanë supozimin për një metatezë të mundshme të grupit \*/-t̪k-/ (→ \*/-k̪p-/) në pozicion tautosilabik edhe për gjegjësen shqipe (sikurse është përfshuar rregullisht në të gjitha gjuhët ie. me përjashtim të hetitishës), mendojmë se grapi në fjalë do t'i nënshtrohej në shqipe në çdo rast një procesi asimilimi drejt /θ/-së, sikurse ka ndodhur kurdoherë në grupet bashkëtingëllore mbylltore, ku rol kryesor ka luajtur kurdoherë elementi i dytë, khs. ie. \*/d<sup>h</sup>(e)g<sup>h</sup>em-/ pranë \*/g<sup>h</sup>ðōm-/ “dhe”: shq. *dhe* (Demiraj 1997 156 me literaturë). Në këtë rast bjerrja e ndërdhëmbores fundore /-θ/ (përkatësisht zëvendësimi i saj me formantin mashkullor të frysorëve {i}) duhet të jetë

<sup>6</sup> Sh. edhe Pokorny IEW 313. Për vështirësinë e përcaktimit të shkallës ablautive në rrokjen nistore të gjegjëses kelte sh. Stempel 1987 109 v.

<sup>7</sup> Sh. për këtë autorin (1997b 206 v.), që për formën në fjalë rindërtion këto shkallë ndërmjetëse: \*/h<sub>1</sub>mos/ : protoshq. \*/(e)mV/ > (nyjë +) \*/m-/> (i/e) em.

përftuar në një periudhë të mëvonshme të zhvillimit gjuhësor, kur në sistemin emëror të gjuhës shqipe gjallonte edhe formanti {-th} me funksion zvogëlues dhe hipokoristik<sup>8</sup>.

Për sa kohë që në indoевropianistikë mbetet i vlefshëm rindërtimi i formës bazë \*/h₂ṛt̥ko-/ pranë \*/h₂ṛk̥pos/ mund të ngérthejmë gjegjësen shqipe *ari* ndër shembujt e sigurtë të zhvillimit të sekuencës \*HRC → \*VRC- në gjuhën shqipe.

7. *elb* - Krahasimit të mëparshëm me gr. ἄλφι, iran. \*arbhi- (Vasmer 1921 16), Hamp-i (1965 132) i shton edhe het. *halki-* “drithë, Korn”, duke rindërtuar kështu një bazë rrëniore të përbashkët me laringal nistor. Ky përfundim duket se nxit edhe Kortlandt-in (1986 44), i cili paraventon për gjegjëset shqipe dhe greke një formë të përbashkët \*/h₂lbʰi-/ (:protoshq. \*/albʰi-/ > me metafoni *elb*), çka përshtatet plotësisht me zhvillimet e sekuencës në shqyrtim<sup>9</sup>.

8. *arē* - Ndryshe nga Hamp-i (1958 237: : \*herA-), që rindërtón për këtë njësi një formë bazë me shkallë ablautive normale, Kortlandt-i (1986 44: \*/h₂ṛh₃-/ vendos për një bazë rrëniore me shkallë ablautive zero, duke e afuar me gr. ἄρουρα “tokë bujqësore”, ἄροτρον, arm. *arcawr* “plug” etj. Krahasimi me lat. *arvum* “tokë e mbjellë” (Demiraj 1997b 80 v.) është në pikëpamje formale dhe kuptimore i patëmetë dhe përshtatet plotësisht me zhvillimet e sekuencës në shqyrtim: (ie. \*/h₂ṛh₃-uo-/ → \*/h₂ṛ-uo-/ : protoshq. \*/arūqā/ > *arē*).

9. *mbē, mē* - Nëpërmjet krahasimeve formale me gr. ἀμφί “mbi, about”, ind. vj. *abhi* etj., gjegjësja e shqipesështë rrjedhuar sipas rastit nga një formë bazë me shkallë ablautive zero: ie. \*/h₂mbʰi/ (Hamp 1965 130), ose normale: ie. \*/h₂embʰi/ (Kortlandt 1986 45, Beekes 1988 102)<sup>10</sup>. Në rastin e rrjedhimit të kësaj njësie nga një formë bazë me shkallë ablautive zero, ruajtja e pacënuar e nistores /m/- të gjegjëses shqipe do të ishte një dëshmi e qartë për veprimin e një procesi të dikurshëm çrrrokjesues, i cili ka parandaluar zhvillimin e rregullt të sonantes rrokjebartëse ie. në shq. /a/. Përgjegjës do të ishte edhe në këtë rast veprimi i laringalit nistor. Ndryshe nga rasti i parafjalëve *ndē* dhe *ndēr* (sh. më sipër), përqasja formale me gjegjësen ind. vj. *abhi* (: ie. \*/h₂mbʰi/ na lejon ta përfshijmë njësinë *mbē, mē*, ndēr rastet e sigurta me sekuencën \*HRC- në gjuhën shqipe).

10. *ēndē* t., *āndē* g. - Afrimi etimologjik i Meyer-it (1891) me ind. vj. áñiti “marr frymë”, gr. ἀνεμος “frymë, afsh”, lejon krahasimin formal me gr. ἀνται ἀνεμοι, ἀντάς πνοάς (Hes.), nord. vj. *andi* “shpir” e më tej saks. vj. *ando*

<sup>8</sup> Për historinë e këtij formanti në gjuhën shqipe sh. Jokl 1926 58. Për fundoren /-i/ me burim formativ te emrat mashkullorë të frymorëve sh. Xhuvani (- Çabej) 1980 476.

<sup>9</sup> Duke afuar etimologjikisht me këto fjale edhe gr. ὄλατ, gr. ion. ούλατ “kokrra drithi”, ὄλυρα “lloj drithi” Demiraj (1997 165), nuk përjashton plotësisht për shq. *elb* mundësinë e rrjedhimit prej një forme bazë me shkallë ablautive -o- të rrënjos: \*/h₂olbʰi-.

<sup>10</sup> Sipas Hamp-it (1977 145) kjo njësi është përfstuar nga rasa instrumentale (e ngurrosur) e një emri ie. \*/h₂en-/ me kuptim “majë, top”, e cila me kohë u ndajsojjezua.

“shqetësim, pezmatim”, duke e shpjeguar gjegjësen e shqipes si një formim deverbativ burimor më \*{-to/-teh<sub>2</sub>} : ie. \**h<sub>2</sub>ŋ(h<sub>1</sub>)-to-* : protoshq. \*/antā/ > g. āndē, t. ēndē (Demiraj 1997 b 170).

### Raste me laringalin \*/h<sub>3</sub>/

Qëmtimi i rasteve të sigurta me sekuencën \**h<sub>3</sub>RC*- është tejet i ndërlikuar për shkallën e njohurive të fituara deri më sot në fonologjinë dhe morfologjinë historike të shqipes. Këtë e pengojnë deri diku si vështirësitet e rindërtimit tematik-strukturor të fondit leksikor ie. të shqipes, ashtu edhe fakti që rezultati përfundimtar i sekuencës \**h<sub>3</sub>RC*- nuk pritet të jetë i ndryshëm nga ai i sekuencës \**HoRC*-, që gjithkund në gjuhët ie. nuk ka lënë gjurmë të laringalit nistor, pavarësisht nga tipari fonologjik (sh. shën 1), khs. ie. \*/h<sub>1</sub>op-ejo-/ : shq. *ap*, *jap*, ind. vj. *āpáyati*, më tej lat. *apīscor* “fitoj, arrij (diçka)” (Demiraj 1997 79 v. me literaturë).

Vështirësi të kësaj natyre kanë dalë në pah edhe gjatë rindërtimit të formës bazë të njësise *ēndērr*, g. *āndēr(r)*, e cila tradicionalisht krahasohet me gjegjëset gr. ὄνταρ, ὄντειρον dhe arm. *anowrj*. Huld-i (1984 63) rindërton për njësinë shqipe një formë bazë me shkallë ablautive normale: \*/h<sub>3</sub>enr-/ (e cila nuk mund të mbështetet), ndërsa Kortlandt-i (1986 44) i rikthehet, ndofta me të drejtë, hezitimit të dikurshëm të Hamp-it (1960 187), duke syuar një formë bazë me shkallë ablautive zero: \*/h<sub>3</sub>nrjō-/<sup>11</sup>.

### Përfundim

Nga sa u kumtua më sipër, vijmë në përfundimin se vëzhgimin e imprehtë të Kortlandt-it, sipas së cilët laringalet ie. \*/h<sub>2</sub>/ dhe \*/h<sub>3</sub>/ mund të jenë vokalizuar në shqipe në pozicion para një rezonanti tautosilabik (sekuencia \*HRC-), sikurse në greqishte, e tumirin edhe raste të tjera nga fondi autokton i shqipes, të cilat ngërthejnë në këtë rregullsi edhe laringalin ie. \*/h/. Zhvillimin paralel të kësaj dukurie në këto dy gjuhë e përforcon edhe ai i përftuar në sekuencën \*HRVC-, ku laringali nistor fillimi shështë vokalizuar, ashtu siç ka ndodhur edhe në armenishtë dhe frigishtë<sup>12</sup>. Hetimi i thelluar i këtyre dukurive dhe zbatimi me konsekuençë i teorisë së laringaleve në albanologji mundëson jo vetëm zgjidhjen e çështjeve ende të hapura në fonologjinë historike të gjuhës shqipe dhe të indoевropianishtes, por lejon edhe syzime më të sigurta lidhur me pozicionin e shqipes në arealin gjuhësor ie.

<sup>11</sup> Demiraj (1997 171) shtron për diskutim si zgjidhje alternative për këtë njësi zërthiminë në *ēn-dēr*, si formim me parashtesim, duke afruar rrënjen e fjalës *-dēr(r)* (: protoshq. -\*drV-/ me bazën ie. \*/dreH-/ “me fjetë”, khs. ind. vj. *nidrā* “përgjumje”).

<sup>12</sup> Përmendim këtu, ndër të tjera, paralelizmin e plotë në zhvillimin e grupave nistore \**Vr-*, \**Hr-* dhe \**yr-*, \*(s)r- që dëshmohet në këto dy gjuhë ie. : protoshq dhe gr. \*/Vr-/ dhe \*/r-/ → shq. *r-* dhe *rr-* përkatesisht gr. *Vp* dhe *þ-* (Demiraj 1994 57 vv.).

### Bibliografi

- Beeks, R. 1988 "Laryngeal Developments: A Survey", në përbledhjen *Die Laryngaltheorie und die Rekonstruktion des idg. Laut- und Formensystems*, Heidelberg, f. 59 - 105.
- 1995 *Comparative Indo-European Linguistics*, Amsterdam-Philadelphia.
- Çabej, E. 1976 *Studime Gjuhësore II*, Prishtinë (= SGJ).
- 1980 sh. më poshtë Xhuvani
- 1997 *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Bleu IV, Tiranë.
- Demiraj, B. 1994 "Bemerkungen zur Entwicklung der anlautenden idg. Laryngale im Albanischen", në përbledhjen *In honorem Holger Pedersen. Kolloquium der Indogermanischen Gesellschaft vom 26. bis 28. März 1993 in Kopenhagen*, Wiesbaden, f. 57 - 76.
- 1997a *Sistemi i numërimit të gjuhës shqipe*, Tiranë.
- 1997b *Albanische Etymologien*, në serinë "Leiden Studies in Indo-European", Bleu VII, Atlanta-Amsterdam
- Demiraj, Sh. 1997 *Fonetikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Hamp, E. 1958 "Albanian *aré*", KZ 75, f. 237-238.
- 1960 "Mythical Prothetic Vowels in Albanian", AION II, 2, f. 185- 190.
- 1965 "Evidence in Albanian", në përbledhjen *Evidence for laryngeals*, Hagë.
- 1976 "On \*HRC- in Latin", Glotta 54, f. 261-263.
- 1977 "Varia II", Eriu 28, f. 145-146.
- Huld, M. 1984 *Basic Albanian Etymologies*, Los Angeles.
- Jokl, N. 1926 "Zum Erbwortsschatz des Albanischen", IF 43, f. 47-65.
- Kortlandt, F. 1986 "Armenian and Albanian", në përbledhjen *La place de l'arménien dans les langues indo-européennes*. Academie Royale de Belgique, Classe des Lettres, Bleu III, f. 38-48.
- Lindeman, F. 1986 "Eine phonologische Bemerkung zur "Vokalisierung" der Laryngale im Indogermanischen", IF 91, f. 79 - 82.
- 1990 "Is there any conclusive evidence for a triple representation of schwa in Armenian?", A. Arm. L 11, f. 25-30.
- Mayrhofer, M. 1986 *Indogermanische Grammatik*, Bleu I-1/2, Heidelberg.
- Meyer, G. 1891 *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg.
- Meillet, A. 1927 "De la prothèse vocalique en grec et en arménien", BSL 27, f. 129-135.
- Ölberg, H. 1927a "Einige Überlegungen zur Laryngaltheorie an Hand des Albanischen", KZ 86, f. 121-136.
- 1927b *Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des*

- Pedersen, H. 1924 *Albanischen und zur diachronen Phonologie auf Grund des Vokalsystems* (punim habilitacioni - drsh. 177 f.), Innsbruck.
- Pokorny, J. 1959 "Albanien", në *Reallexikon der Vorgeschichte*, Bleu I, f. 222-224.
- Rix, H. 1969 *Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch*, Bleu I, Bern-München.
- Schindler, J. 1973 "Anlautender Nasal vor Liquida und Nasalis Sonans im Griechischen", MSS 31, f. 79-111.
- 1977 "Zum Ablaut der neutralen *s*-Stämme des Indogermanischen", në përmblehdhjen *Akten der V. Fachtagung der idg. Gesellschaft*, Wiesbaden, f. 259-267.
- Stempel, P. B. 1987 "A thorny Problem", Sprache 23, f. 25-35.
- Die Vertretung der indogermanischen Liquiden und Nasalen Sonanten im Keltischen*, në serinë IBS, Bleu 54, Innsbruck.
- Vasmer 1921 *Studien zur albanischen Wortbildung I*, në *Acta et Commentationes Universitatis Dorpatensis*, Dorpat.
- Xhuvani, A. 1980 *Vepra I*, Tiranë.